



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija za Privatizaciju

Raporti Financiar

Për periudhën e përfunduar deri me 31 Dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE	5
RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	6
SHËNIMI 1 INFORMATA PËR ORGANIZATËN DHE POLITIKAT KONTABËL	7
1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE	7
1.2. SUBJEKTI RAPORTUES	7
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA	8
1.4. LLOGARIA E VETME E THESARIT (LLVTH)	8
1.5. KTHIMET E SHPENZIMEVE NGA VITI PARAPRAK	8
1.6. VALUTA DHE SHUMA RAPORTUESE	9
1.7. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	9
SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA	9
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME	10
3.1. BUXHETI NGA GRANTI QEVERITAR	11
3.2. BUXHETI NGA TË HYRAT E DEDIKUARA	12
3.3. PAGESAT E REALIZUARA	12
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE	15
SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	15
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE	16
SHËNIMI 7 KTHIMI I HUAMARRJEVE	17
SHËNIMI 8 TJERA	17
SHËNIMI 9 TË HYRAT TATIMORE	17
SHËNIMI 10 TË HYRAT JO TATIMORE	17
SHËNIMI 11 TË HYRAT E DEDIKUARA	17
11.1. Të hyrat e dedikuara për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative të AKP-së	19
SHËNIMI 12 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE	20
SHËNIMI 13 HUAMARRJET	20
SHËNIMI 14 TË ARKËTUESHMET	20
SHËNIMI 15 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA	21
SHËNIMI 16 DETYRIMET KONTINGJENTE	22
SHËNIMI 17 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)	23

SHËNIMI 18 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO).....	23
SHËNIMI 19 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA.....	24
SHËNIMI 20 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE	24
SHËNIMI 21 RAPORT PËR NUMRIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE	25
SHËNIMI 22 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	26

ANEKSI I PASQYRAVE FINANCIARE:

TABELA 1 – RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	1
TABELA 2 – PASQYRA KRYESORE.....	2
TABELA 3 – DETAJET E FATURAVE TË PAPAGUARA	3/6
TABELA 4 – RAPORTI I PASURIVE	7
TABELA 5 – LISTA DETAJE E ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE	8/17
RAPORTI I AKTIVITETEVE	1/35

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE**Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për periudhën Janar – Dhjetor 2017

		2017		2016		2015	
		Llogaria e vetme e Thesarit	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit	Pagesat nga palët e treta të jashtme
	Shënime	BKK		BKK		BKK	
BURIMET E FONDEVE							
Granti qeveritar		652,960	-	9,515	-	10,573	-
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara		6,223,303	-	6,303,375	-	5,959,695	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve		-	-	-	-	-	-
Huamarrjet		-	-	-	-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim		-	-	-	-	-	-
Pranimet tjera		-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJ	6,876,263	-	6,312,890	-	5,970,268	-
SHFRYTEZIMI I FONDEVE							
Operacionet							
Paga dhe roga	2	4,390,281	-	4,402,591	-	4,321,066	-
Mallra dhe shërbime	3	2,349,780	-	1,745,292	-	1,401,519	-
Shpenzime komunale	4	80,913	-	73,594	-	84,980	-
	GJITHSEJ	6,820,974	-	6,221,477	-	5,807,565	-
Transferet							
Transfere dhe subvencione	5	41,379	-	78,809	-	116,003	-
Shpenzime kapitale							
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	13,910	-	12,603	-	46,700	-
Kthimi i huamarrjeve	7	-	-	-	-	-	-
Pagesa tjera	8	-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJ	6,876,263	-	6,312,890	-	5,970,268	-

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT**Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për periudhën Janar – Dhjetor 2017

		Janar – Dhjetor 2017				2016	2015
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Varianca	Realizimi	Realizimi
Shënime		A	B	C	D=C-B	E	F
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	9	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	10	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	11	6,920,884	6,920,884	6,111,946	(808,938)	7,199,729	6,811,383
Grantet e përcaktuara të donatorëve	12	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	13	-	-	-	-	-	-
Tjera	14	-	-	-	-	-	-
Gjithsej Pranimet e mbledhura në FKK-në		6,920,884	6,920,884	6,111,946	(808,938)	7,199,729	6,811,383
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Paga dhe rroga	2	4,402,884	4,402,884	4,390,281	(12,603)	4,402,591	4,321,066
Mallra dhe shërbime	3	2,380,000	2,948,920	2,349,780	(599,140)	1,745,292	1,401,519
Shpenzime komunale	4	98,000	118,000	80,913	(37,087)	73,594	84,980
Transfere dhe subvencione	5	40,000	50,000	41,379	(8,621)	78,809	116,003
Shpenzime kapitale	6	100,000	100,000	13,910	(86,090)	12,603	46,700
Kthimi i huamarrjeve	7	-	-	-	-	-	-
Tjerat	8	-	-	-	-	-	-
Gjithsej pagesat e bëra nga BRK nëpërmes LIVTh		7,020,884	7,619,804	6,876,263	(743,541)	6,312,889	5,970,268

AKP për të mbuluar shpenzimet e planifikuara sipas ndarjeve buxhetore dhe planit të rrjedhës së parasë të dorëzuar në Thesar, depoziton mjetet në Fondin e Kosovës sipas Ligjit të buxhetit (Ligji Nr. 05/L-125, neni 8 paragrafi 6) të aprovuar nga Kuvendi. Në raportin e hyrjes të parasë së gatshme në llogari të Thesarit (shih më lart) paraqitet vetëm transferimi i mjeteve shtesë prej EUR 6,100,000 e realizuar më 20 Janar 2017 nga fondi i 5% nga të Hyrat e Dedikuara të AKP-së. Pjesa prej EUR (808,938) e paraqitur tek varianca, përkatësisht në kolonën D, mbulohet nga tepricat e pashpenzuara të buxhetit 2017. Buxheti i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për AKP për vitin fiskal 2017 në vlerën prej **EUR 6,920,884 nuk është planifikim i të hyrave por planifikim i shpenzimeve**. Për kujdesin e juaj, AKP-ja nuk planifikon të hyra si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave është kërkuar që të raportohet në këtë mënyrë.

Shuma prej EUR 11,946 është kthim i mjeteve për shpenzimet e telefonisë mobile, pagesa e kthyer që është ekzekutuar nga përmbaruesit dhe raste tjera. *Këto raste trajtohet sipas situatës të shënimit nr. 1.5, 11 dhe 19 të shënimit shpjegues.*

SHËNIMI 1 INFORMATA PËR ORGANIZATËN DHE POLITIKAT KONTABËL

1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik e bazuar në para të gatshme.

Pasqyrat financiare i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga udhëzimet administrative të Ministrisë së Financave dhe janë të bazuar në shënime financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare formojnë pjesën përbërëse të pasqyrave financiare dhe duhet të lexohen së bashku dhe në ndërlidhje me pasqyrat financiare.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë tërë periudhës raportuese.

1.2. SUBJEKTI RAPORTUES

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i gjashtë (6) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ka përfunduar në muajin dhjetor 2017, në përjashtim të Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, mandati i të cilëve skadon në muajin dhjetor 2018.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve) nëpërmjet të metodave të "spin off-it" dhe shitjeve të aseteve përmes procesit të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore. Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës të NSh-ve në Kosovë.

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej **1 janar deri më 31 dhjetor 2017**. Aktivitetet e AKP-së gjatë periudhës raportuese janë financuar nga **Të hyrat e Dedikuara të AKP-së (THD) dhe Granti Qeveritar (GQ).**

Sipas Ligjit të LMFPP-së (neni 64) dhe Ligjit të AKP-së 04/L-034 (neni 21), **Të hyrat e Dedikuara (THD)** janë 5% i të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, është tarifë administrative për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative.

Granti Qeveritar (GQ) është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, nga Granti Qeveritar janë financuar aktivitetet që kanë të bëjnë me riorganizimin e NSh-së në këtë rast Ndërmarrjen Trepça, e cila deri në periudhën raportuese, ka qenë nën kompetencën e Agjencisë sipas Ligji nr. 04/-L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre.

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA

Janë pagesa që realizohen **nga palët e treta për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**, për paga, mallra, shërbime apo çfarëdo shpenzimi tjetër ndaj operatorëve ekonomik.

Ashtu siç është paraqitur në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave, gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar asnjë rast, për të cilat, palët e treta do t'i realizonin pagesat ndaj operatorëve ekonomik.

1.4. LLOGARIA E VETME E THESARIT (LLVTH)

Nga Granti Qeveritar, pranimi i të hyrave dhe realizimi i pagesave bëhet vetëm nëpërmjet llogarisë kryesore të Thesarit, të cilën e menaxhon dhe administron Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave. Meqenëse sipas Ligjit nr. 04/L-034, mjet kryesor i financimit të aktiviteteve të AKP-së janë të hyrat e dedikuara, Thesari ka hapur një llogari ekskluzivisht për AKP-në. Kjo llogari menaxhohet dhe administrohet nga Thesari si llogaria kryesore.

Llogaria e hapur nga Thesari në të cilën i pranon mjetet nga AKP-ja për mbulimin e shpenzimeve është: Privatizimi Tarifa Administrative” me numër të llogarisë 1000400070004642. Në përputhje me ligjin nr. 04/L-034, tepricat (mjetet e pashpenzuara) barten për mbulimin e shpenzimeve të vitit pasues.

Nga viti fiskal 2012, shpenzimet operative dhe administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbulohen nga Të Hyrat e Dedikuara (THD).

Sa i përket fondeve në mirëbesim, bazuar në ligjin mbi themelimin e AKP-së dhe procedurave bankare të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, AKP operon me llogaritë bankare në mirëbesim të mbajtura në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Pasqyrat Financiare dhe Shënimet Shpjeguese të Fondeve në Mirëbesim sipas nenit 20 të Ligjit të AKP-së janë paraqitur ndaras nga Pasqyrat Financiare të AKP-së.

1.5. KTHIMET E SHPENZIMEVE NGA VITI PARAPRAK

Sipas Ligjit MFPP, gjatë periudhës raportuese, mjetet e kthyera për korigjim apo rimbursim të pagesave për vitet paraprake, regjistrohen si “të hyra nga vitet e kaluara”, ndërsa për shpenzimet e vitit aktual stornohen apo regjistrohen si zbritje të shpenzimeve.

1.6. VALUTA DHE SHUMA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në tabelat përkatëse.

1.7. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare janë autorizuar për lëshim më **29 janar 2018** nga: Ekrem Hajdari, Drejtor Menaxhues, AKP, dhe Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit, AKP.

SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA

Përshkrimi	Janar – Dhjetor 2017					2016	2015
	Buxheti	Pagesat		Gjithsej		Pagesat	Pagesat
	Final €	GQ €	THD €	Pagesat €	Krahasimi %	€	€
Pagat neto përmes listës së pagave	3,645,000	-	3,638,852	3,638,852	99.83%	3,649,751	3,584,559
Pagesa për sindikatë	-	-	-	-	-	-	-
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-	-	-	-	-	-	-
Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	-	-	-	-	-	-	-
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	338,562	-	333,496	333,496	98.50%	333,543	324,976
Kontributi pensional-punëtori	209,661	-	208,967	208,967	99.67%	209,649	205,766
Kontributi pensional-punëdhënësi	209,661	-	208,967	208,967	99.67%	209,649	205,766
GJITHSEJ PAGA DHE RROGA	4,402,884	-	4,390,281	4,390,281	99.71%	4,402,591	4,321,066

Buxheti i aprovuar për vitin fiskal 2017 është në vlerën prej **EUR 4,402,884** dhe është ndarë në programin “Administrata Qendrore” të AKP-së.

Ashtu siç është paraqitur edhe në tabelën e mësipërme, gjatë këtij viti fiskal, burim i vetëm i financimit për mbulimin e pagave dhe mëditjeve për punëtorët e AKP-së janë **të hyrat e dedikuara (THD)**

Numri i punëtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2017 është gjithsej 258 zyrtarë. [Shih edhe në shënimin shpjegues nr 20.](#)

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Ministrisë së Administratës Publike, në të cilën, AKP-ja dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse. Ministria e Administratës Publike pas analizave përcjell informatat tek Ministria e Financave e cila procedon pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME

Shumat e paraqitura në tabelën e mallrave dhe shërbimeve janë financuar nga të Hyrat e Dedikuara (THD) dhe për Trepçën nga Granti Qeveritar (GQ). Më poshtë janë paraqitur dhe shpalosur në detaje shënimet lidhur me dy burimet e financimit për buxhetin e AKP-së.

Përshkrimi	Janar – Dhjetor 2017				2016	2015
	Buxheti	Pagesat		Gjithsej	Krahasimi	Pagesat
	Final €	GQ €	THD €	Pagesat €		Pagesat €
Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	0%	4,654
Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit	2,250	-	856	856	38%	-
Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar jashtë vendit	12,000	-	11,574	11,574	96%	-
Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,250	-	167	167	13%	-
Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashtë vendit	10,000	-	2,484	2,484	25%	2,386
Shpenzimet për internet	11,300	-	3,130	3,130	28%	3,456
Shpenzimet e telefonisë mobile	45,400	-	41,083	41,083	90%	44,143
Shpenzimet postare	13,400	-	3,008	3,008	22%	1,723
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	30,000	-	23,394	23,394	78%	17,363
Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	28,300	-	2,425	2,425	9%	6,181
Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	375,800	-	375,387	375,387	100%	348,898
Shërbime shtypje- jo marketing	9,000	-	194	194	2%	1,731
Shërbime Kontraktuese Tjera	1,269,097	651,986	393,967	1,045,953	82%	519,699
Shërbime Teknike	20,600	974	7,474	8,448	41%	7,659
Mobile (me pak se 1000 euro)	7,600	-	225	225	3%	6,908
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	0%	14,158
Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	27,000	-	26,503	26,503	98%	36,311
Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	8,000	-	2,620	2,620	33%	1,080
Furnizime për zyrë	45,000	-	41,245	41,245	92%	38,851
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	29,300	-	25,157	25,157	86%	14,944
Furnizime pastrimi	10,000	-	6,902	6,902	69%	9,339
Furnizim me veshmbathje	8,000	-	-	-	0%	-
Akomodimi	-	-	-	-	0%	-
Nafte për ngrohje qendrore	46,000	-	37,330	37,330	81%	35,204
Derivate për gjenerator	11,200	-	2,408	2,408	21%	1,264

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Karburant për vetura	34,200	-	28,195	28,195	82%	23,986	28,794
Vaj	4,500	-	709	709	16%	21	40
*Avanc	15,000	-	-	-	0%	-	-
Regjistrimi i automjeteve	6,620	-	150	150	2%	3,125	2,250
Sigurimi i automjeteve	9,000	-	6,899	6,899	77%	8,405	7,395
Taksa komunale e regjistrimit të automjeteve	380	-	-	-	0%	350	270
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	40,500	-	30,963	30,963	76%	20,710	23,846
Mirëmbajtja e ndërtesave	2,000	-	529	529	26%	651	7,804
Mirëmbajtja e Teknologjisë Informativë	18,913	-	17,681	17,681	93%	14,035	13,193
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	16,500	-	495	495	3%	14,538	20,660
Qiraja për ndërtesa	247,500	-	242,140	242,140	98%	414,334	420,564
Qiraja për përdorime tjera hapësinore	170,310	-	170,310	170,310	100%	-	-
Reklamat dhe konkurset	4,800	-	2,769	2,769	58%	5,988	807
Botimet e publikimeve	12,000	-	5,389	5,389	45%	-	-
Shpenzimet për informim publik	302,100	-	173,434	173,434	57%	88,768	10,829
Drekat zyrtare	10,000	-	6,216	6,216	62%	8,539	3,225
Shpenzime-vendimet e gjykatave	34,100	-	3,407	3,407	10%	25,890	39,666
GJITHSEJ MALLRA DHE SHËRBIME	2,948,920	652,960	1,696,820	2,349,780	80%	1,745,292	1,401,519

*Avanc ka qenë e buxhetuar për parane e imët që është mbajtur në arkë. Të gjitha pagesat prej EUR 5,831 janë kategorizuar sipas planit kontabël, kurse bilanci tani është zero pas kthimit të mjeteve të pashpenzuar.

3.1. BUXHETI NGA GRANTI QEVERTAR

Buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” ka qenë EUR 100.000.00. Gjatë rishikimit sipas Ligjit të buxhetit Nr. 06/L-002, buxheti nga Granti Qeveritar (GQ) është rritur për EUR 598,920.00.

AKP, në kërkesën buxhetore të dorëzuar në Ministrinë e Financave nga Granti Qeveritar (GQ) për vitin 2017 për Riorganizimin e Trepçës ka kërkuar mjete në shumë prej EUR 698,920.00. Qëllimi i mjeteve të kërkuara ka qenë mbështetja e punëve të nevojshme për përgatitjen e Planit të Riorganizimit të Trepçës dhe në veçanti angazhimi i OShP-së për Studimin e Fizibilitetit të Trepçës i cili është iniciuar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Pavarësisht kërkesës së AKP-së, Ministria e Financave fillimisht nuk kishte aprovuar kërkesën buxhetore në tërësi.

Për të mos ngecur në realizimin e pagesës, gjatë procesit të rishikimit të buxhetit 2017, AKP ka kërkuar nga MF aprovimin e buxhetit shtesë për vlerën e kontratës së nënshkruar në mes AKP dhe OShP-së në shumë prej EUR 598,920.00.

Ministria e Financave dhe Kuvendi sipas Ligjit të rishikimit të buxhetit Nr. 06/L-002 nga Granti Qeveritar ka aprovuar rritjen e buxhetit sipas kërkesës së AKP-së dhe buxheti përfundimtar për vitin 2017 është EUR 698,920.00.

3.2. BUXHETI NGA TË HYRAT E DEDIKUARA

Për të Hyrat e Dedikuara, buxheti i aprovuar për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” është EUR 2,250,000.00. Para procesit të rishikimit të buxhetit kemi pasur transfere ndërmjet programeve buxhetore. Shih tabelën e mëposhtme:

PËRSHKRIMI	VLERA	Shuma e transferit	Buxheti pas transfereve
Likuidimi - (zvogëlim i buxhetit nga kodet e shpenzimeve për informim publik).	540,000	(80,000)	460,000
Administrata Qendrore - (rritje e buxhetit të kodit të shërbimeve tjera kontraktuese)	1,320,000	50,000	1,370,000
Privatizimi - (rritje e buxhetit të kodit të shpenzimeve për informim publik)	200,000	30,000	230,000

3.3. PAGESAT E REALIZUARA

Sa i përket pagesave, në mënyrë që lexuesi të ketë një pasqyrë më të qartë, do të pasqyrohen më në detaje në tabelat e mëposhtme, pasi që brenda një kategorie (kodit ekonomik të shpenzimeve) janë realizuar pagesa për shërbime të ndryshme dhe që kanë vlera të mëdha.

3.3.1 Shërbimet kontraktuese tjera në shumën prej EUR 1,045,953 përfshinë pagesat si më poshtë:

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
*Pagesa ndaj Ofruesit të shërbimeve profesionale për studimin e fizibilitetit për Trepçën në shumën prej EUR 598,920 si dhe interesin krijuar për vonesën në pagesë prej EUR 35,935.20 – Granti Qeveritar	634,855	60.70%
Pagesat ndaj BSPK-së, kompensimin e shpenzimeve mujore. Ky kompensim bëhet në përputhje me vendimin e Bordit të Drejtorëve	51,228	4.90%
Shërbimet e sigurimit të Zyrave të AKP-së ndaj operatori ekonomik “Policia e Kosovës”	176,440	16.87%
Vlerësim dhe Auditimi i NSH Dubrava Live Stock, NSH “IDGJ Tobacco” dhe NSH “Emin Duraku”	6,889	0.66%
Shpenzime për përkthim të dokumentacionit për interes publik	7,131	0.68%
Pagesat e trusteve pensionale dhe tatimit në të ardhura personale për Ofruesit e Shërbimeve	15,248	1.46%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për analizë të raportit të fizibilitetit për Trepçën – Granti Qeveritar	15,098	1.44%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për ruajtjen e aseteve të NSH-ve para se të hyjnë në likuidim	32,526	3.11%
Sigurimi i mbulimit të përgjegjësisë për Drejtoret e Bordit të AKP-së dhe disa zyrtarëve të Lartë të AKP-së	31,624	3.02%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për shërbimet e tjera administrative sidomos për NSH në transicion	55,785	5.33%
Punëtori për organizimin e planit të punës të AKP-se për vitin 2018	3,460	0.33%
**Ekzekutimi i pagesave nga Thesari i Ministrisë së Financave ndaj përmblyesve privat	10,583	1.01%
Pagesa për shpërblym në pagë pas daljes në pension si dhe një pjesë e pagës për ish-zyrtarin e AKP-së i cili është emëruar Gjykatës.	2,166	0.21%
Shpenzime tjera	2,920	0.28%
GJITHSEJ PAGESATEREALIZUARA NË KATEGORINË “SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA”	1,045,953	100%

***Pagesa e interesit prej EUR 35,935.20** ka ndodhur si rezultat i tejkalimit të afatit të pagesës në shumën prej EUR 598,920 ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale. Afati i pagesës ka qenë në qershor 2017, ndërsa kjo pagesë është realizuar në muajin nëntor 2017. Agjencia Kosovare e Privatizimit gjatë vitit 2016, duke u mbështetur në Ligjin e Buxhetit në shumën prej EUR 1,816,039 të aprovuar nga Granti Qeveritar (GQ) për planin e riorganizimit të Trepçës, ka iniciuar dhe përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit publik për realizimin e “Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj” dhe me datën 20 shtator 2016 ka nënshkruar kontratën me Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (OSHP) në vlerë prej EUR 598,920. Meqenëse shërbimi i kontraktuar do të zgjatej /bartej edhe në vitin 2017, AKP përmes kërkesës buxhetore të dorëzuar në MF ka kërkuar aprovimin e buxhetit për vlerën e kontratës së nënshkruar në shumë prej EUR 598,920, për përmbushjen e obligimit financiar ndaj OSHP-së i cili është prituri të realizohet në kuartalin e parë ose të dytë të vitit 2017. Pavarësisht kërkesës së AKP-së, Ministria e Financave nuk kishte aprovuar kërkesën dhe si rrjedhojë përmes shkresave zyrtare edhe disa herë kemi njoftuar MF dhe kemi kërkuar alokimin e buxhetit duke i njoftuar për kushtet dhe termat e pagesës sipas kontratës së nënshkruar.

Së fundmi, përmes procesit të rishikimit të buxhetit gjysmë-vjetor, AKP-ja ka paraqitur kërkesën për rritje të buxhetit, të cilën Qeveria e kishte aprovuar. Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar Ligjin e rishikimit tek në muajin nëntor 2017, dhe si rezultat i kësaj vonese (alokimit të mjeteve nga MF për realizimin e pagesës) OSHP-ja ka aplikuar kamatë ditore për vonesën në pagesë e cila ka qenë në përputhje me nenin 16.5 të kontratës të nënshkruar ndërmjet dy palëve.

****Ekzekutimi i pagesave nga Thesari i Ministrisë së Financave ndaj Përmbaruesve Privat.** Departamenti i Thesarit ka ekzekutuar dy pagesa ndaj përmbaruesit privat në shumën totale prej EUR 10,583, shuma totale e cila përbën pagesën e obligimeve dhe interesit ndaj Grupit Koha në shumën prej EUR 9,402.51 si dhe pagesën prej EUR 1,180.70 për obligimet e pretenduara ndaj “Siguria”.

Sa i përket pagesës të obligimeve ndaj Grupit Koha, në shumën prej EUR 6,365, këto obligime kanë qenë të prezantuara në pasqyrat financiare 2016 tek obligimet kontingjente të AKP-së si dhe obligimet e papaguara në fondet në mirëbesim për NSH-të përkatëse. Këto obligime nuk kanë qenë brenda vlerës të kontraktuar, mirëpo në anën tjetër, AKP-ja kishte bërë porosi për shpallje të cilat Grupi Koha i kishte publikuar për shpalljen e listave punëtoreve për 20%. Menaxhmenti për të ikur ndëshkime, kamatave dhe tarifave që aplikohen nga përmbaruesit ka marrë vendim që këto obligime të paguheshin në mënyrë që të eliminoheshin kostot tjera përmbarimore.

Në të njëjtën kohë, në vitin 2016 sipas marrëveshjes në takimin e mbajtur në mes dy palëve, ishin pajtuar që pas realizimit të pagesës të obligimeve, Grupi Koha do të tërhiqej nga të gjitha procedurat e iniciuara përmbarimore. Në fund të vitit 2017, AKP-ja ka kuptuar që pala nuk ishte tërhequr nga procedura përmbarimore dhe se Thesari ka ekzekutuar mjetet duke përfshirë edhe interesin, që në total janë EUR 9,402.51. AKP-ja ka kërkuar që këto mjete të kthehen, pasi që përbën ekzekutim të dyfishtë të mjeteve, me nga EUR 6,365 (pagesa në vitin 2016 dhe tani në 2017), si dhe interesin dhe kosto tjera përmbarimore, që sipas marrëveshjes, operatori do të duhej të tërhiqej nga këto procedura. Ne kemi përcjell shkresat ndaj Grupit Koha që të bëjë kthimin e mjeteve, mirëpo, “Grupi koha” ka kthyer vetëm shumën prej EUR 6,365 të obligimeve, ndërsa pjesën tjetër të kostove përmbarimore prej EUR 3,037.51 nuk i ka kthyer ende. AKP-ja do të shqyrtojë rrugët ligjore që pala të bëjë kthimin e mjeteve. *Shuma e kthyer prej EUR 6,365 është paraqitur në shënimin shpjegues nr. 11 si dhe në shënimin shpjegues nr. 19.*

Gjithashtu edhe për rastin “Siguria”, AKP-ja ka shikuar të gjithë dokumentacionin dhe ka vërtetuar se nuk ka asnjë obligim ndaj këtij operatori. AKP-ja për shpenzimet e vitit 2008 i ka përfunduar pagesat ndaj shpeditit “Forca”, përmes të cilit, sipas kontratës janë pranuar shërbimet e “Siguria”. Edhe për këtë rast, AKP-ja ka kërkuar që të bëhet kthimi i mjeteve, dhe në qoftë se këto mjete nuk kthehen, AKP-ja do të ndjek procedurat ligjore.

Gjithashtu, në anën tjetër, AKP-ja ka ngritur shqetësim edhe në Departamentin e Thesarit, i cili nuk na ka njoftuar përmes të gjitha rrugëve të komunikimit, siç ka qenë edhe më përpara praktik. Pra, Thesari do të duhej të sigurohej saktësisht dhe në mënyrë të plotë për rastet në fjalë dhe jo të ndërmer veprime, pa marrë “feedback” e plotë të AKP-së.

3.3.2. Shërbimet të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse në shumën prej EUR 375,387

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
Kompensimi në vlerën neto i anëtarëve të Bordit për mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme	301,661	80.36%
Kompensimi në vlerën neto për Komitetin e Auditimit	5,046	1.34%
Kompensimi për anëtarët e komisionit (palët e jashtme) për hapjen e ofertave të shitjeve	1,900	0.51%
Kontributet dhe tatimet për Bordin, komiteteve dhe anëtarët e komisionit për hapjen e ofertave të shitjes	66,780	17.79%
GJITHSEJ PAGESAT PËR SHËRBIMET TË NDRYSHME INTEKELTUALE DHE KËSHILLËDHËNËSE	375,387	100%

3.3.2.1 Shpalosje e Pagesave ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së

Për periudhën raportuese pagesat në vlerën neto të realizuara ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së, pasqyrohen si më poshtë:

Përshkrimi	Bruto	Kontributet	Kontributet	Tatimi	Ndalesa tjera	Pagesat neto
Për mbledhje të Bordit	348,816	13,313	13,313	35,350	292	301,661
Për komisionet	5,800	193.00	193.00	561	0.00	5,046
Gjithsej	354,616	13,506	13,506	35,911	292	306,707

Pagesat e realizuara gjatë periudhës raportuese kanë të bëjnë me aktivitetet e mëposhtme:

1. Mbledhjet e Bordit – 17 mbledhje (mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme);
2. Mbledhje të Komisionit të Auditimit. Për periudhën janar - dhjetor 2017 janë mbajtur katër takime të komitetit të Auditimit.

3.3.3. Shpenzimet – Vendimet e Gjykatave në shumën prej EUR 3,407:

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
Kompensim të pagave të papaguara për kthimin e zyrtarit në punë	1,547	45%
Taksat gjyqësore prej EUR	1,860	55%
GJITHSEJ TAKSAT DHE VENDIMET E GJYKATAVE	3,407	100%

SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE

Për periudhën raportuese, burim i financimit për shërbime komunale janë të hyrat e dedikuara **(THD)** të Agjencisë. Pagesat e shërbimeve publike përfshijnë të gjitha pagesat e bëra për zyrën Qendrore dhe zyrat regjionale të AKP-së.

Përshkrimi	Janar – Dhjetor 2017					2016	2015
	Buxheti	Pagesat		Gjithsej		Pagesat	Pagesat
	Final €	GQ €	THD €	Pagesat €	Krahasimi %	€	€
Rryma	79,500	-	66,168	66,168	83%	61,034	72,151
Uji	6,500	-	6,204	6,204	95%	4,968	1,767
Mbeturinat	6,000	-	3,233	3,233	54%	3,045	2,982
Ngrohja Qendrore	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet telefonike	26,000	-	5,308	5,308	20%	4,547	8,080
Pagesa-vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ SHPENZIMET KOMUNALE	118,000	-	80,913	80,913	69%	73,594	84,980

SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Për periudhën raportuese, burim i financimit për subvencione dhe transferë janë të Hyrat e Dedikuara **(THD)** të Agjencisë.

Shuma prej EUR 50,000.00 e dedikuar në kategorinë e subvencioneve është për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.

Përshkrimi	Janar – Dhjetor 2017					2016	2015
	Buxheti	Pagesat		Gjithsej		Pagesat	Pagesat
	Final €	GQ €	THD €	Pagesat €	Krahasimi %	€	€
Subvencione për entitetet publike	50,000	-	41,379	41,379	83%	78,809	116,003
Subvencionet për entitetet publike (tea.bib)	-	-	-	-	-	-	-
Subvencione për entitetet jopublike	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ SHPENZIMET KOMUNALE	50,000	-	41,379	41,379	83%	78,809	116,003

SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE

Për periudhën raportuese, burim i financimit për investime kapitale janë të hyrat e dedikuara (THD) të Agjencisë.

Për vitin 2017 janë tri projekte kapitale të aprovuara:

1. Pajisjet mbi EUR 1,000 brenda shpenzimeve kapitale;
2. Riparimi i ndërtesës së AKP-së dhe Zyrave Rajonale; dhe
3. Blerja e veturave zyrtare.

Gjatë periudhës raportuese, është realizuar vetëm një pagesë prej **EUR 13,910** për furnizim me pasie të IT-së.

Buxheti i aprovuar në vlerë prej EUR 75,000.00 për blerjen e veturave zyrtare nuk është shpenzuar për arsye se Agjencia Qendrore e Prokurimit sipas Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria e Kosovës ka iniciuar dhe ka zhvilluar procesin e prokurimit për furnizim me vetura në emër të gjitha autoriteteve kontraktuese të nivelit qendror dhe lokal. Ky tender ende është në proces të vlerësimit nga komisioni i AQP-së. Gjithashtu edhe buxheti i aprovuar në shumë prej EUR 5,000.00 për Riparimin e ndërtesës së AKP-së dhe Zyrave Rajonale nuk është shpenzuar për arsye se nuk kemi lëvizur në objektin e ri.

Përshkrimi	Janar – Dhjetor 2017				2016	2015
	Buxheti	Pagesat		Gjithsej	Pagesat	Pagesat
	Final €	GQ €	THD €	Pagesat €	Krahasimi %	€
Vetura Zyrtare	75,000	-	-	-	0%	-
Ndërtesat e banimit	5,000	-	-	-	0%	-
Mirëmbajtja investive	-	-	-	-	0%	2,655
Pajisje të teknologjisë informative	20,000	-	13,910	13,910	70%	9,948
GJITHSEJ SHPENZIMET KOMUNALE	100,000	-	13,910	13,910	14%	46,700

SHËNIMI 7 KTHIMI I HUAMARRJEVE

Agjencia nuk është e përfshirë në huazimin e fondeve.

SHËNIMI 8 TJERA

AKP-ja pranon depozitat e ofertuesve për pjesëmarrje në tender si depozitë e sigurisë. Këto mjete kthehen në rastin kur këta ofertues nuk janë fitues. Rastet kur ofertuesit janë fitues të përkohshëm mirëpo nuk arrijnë t'i plotësojnë kriteret tjera si p.sh. realizimin e pagesës të shumës blerëse brenda afatit kohor, depozitat e tyre konfiskohen dhe njihen si të hyra. Rastet e tilla paraqiten si të hyra në *nr. 11 të shënimeve shpjeguese*. Detaje lidhur me këto të hyra janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

SHËNIMI 9 TË HYRAT TATIMORE

Nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të Agjencisë.

SHËNIMI 10 TË HYRAT JO TATIMORE

Të hyrat nga licencat, të hyra nga pasuritë, të hyra nga shitja e shërbimeve, gjoba dhe taksa të aplikueshme nga AKP-ja, në këtë kategori, për këtë periudhë raportuese nuk ka të hyra.

Të gjitha të hyrat e realizuara që trajtohen dhe janë për AKP-në, njihen si të hyra të dedikuara. Për detaje, *referojuni shënimit shpjegues nr. 11*.

SHËNIMI 11 TË HYRAT E DEDIKUARA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të hyrat e dedikuara janë përshkruar si më poshtë:

1. Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operativeve; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia menjëherë transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së; Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë;

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

2. Të gjitha të ardhurat e dedikuara të Agjencisë i nënshtrohen procesit të përvetësimit të krijuar nga LMFP për agjencitë e pavarura. Çdo e hyrë e tillë e dedikuar që nuk është përvetësuar nga Agjencia për t'u shpenzuar gjatë vit kalendarik sipas Ligjit përkatës të përvetësimit vjetor, mbahet në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë dhe mund të shfrytëzohet vetëm për bërë përvetësime në të ardhmen për Agjencinë.

Të hyrat e realizuara vetëm për periudhën raportuese janë EUR 3,030,418 (përfshirë edhe kthimet e mjeteve të telefonisë fikse dhe mobile)

Përshkrimi	Shënime	2017	2016	2015	% e totalit	% e ndryshimit
		€	€	€	2017	2016
ati1 - Interes i fituar mbi tarifën administrative të Agjencisë	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	500	0.00%	0.0%
ati2 - 5% e shitjeve nga likuidimi	PF - Fondet në mirëbesim	1,305,800	6,778	546,163	43.09%	19166.0%
ati3 - 5% nga shitja prej privatizimit	PF - Fondet në mirëbesim	10,157	165,693	-	0.34%	-93.9%
ati4 - 5% e të ardhurave të komercializimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.0%
ati5 - 5% e të ardhurave të tjera nga NSH nëse ka	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.0%
ati6 - nga Fondi Rezervë i AKP-së	PF - Fondet në mirëbesim	1,162,515	-	-	38.36%	0.0%
ati7 - nga Llogaria për Deponimin e Ofertës për Privatizim	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.0%
ati8 - nga Tarifa për Dorëzimin e Ofertës për Privatizim	PF - Fondet në mirëbesim	-	267,527	(28,690)	0.00%	-100.0%
ati9 - nga Llogaria për Deponimin e Ofertës në Likuidim	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	31,407	0.00%	0.0%
ati10 - nga Tarifa për Regjistrim për Likuidim	PF - Fondet në mirëbesim	540,000	335,609	-	17.82%	60.9%
ati11 - 5% e interesit në Llogarinë Bankare të Likuidimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.0%
ati12 - nga Llogaria për Deponimin e Shqyrtimit të Likuidimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	5,487	0.00%	0.0%
Konfiskimi i depozitave nga valët e privatizimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.0%
Konfiskimi i depozitave nga valët shitja e aseteve përmes likuidimit	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	-	0.00%	0.0%
Inkasimet nga përdorimi i telefonisë mobile dhe tjera	Shënimi nr 19.	11,946	10,418	4,800	0.39%	14.7%
Inkasimet e kapitalit themeltar të paguar më parë	PF - Fondet në mirëbesim	-	-	60,369	0.00%	0.0%
GJITHSEJ		3,030,418	786,025	620,034	100%	286%

PF- Fondet në mirëbesim janë të prezantuara në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim, përkatësisht të hyrat në llogarinë bankare të tarifës administrative që Agjencia Kosovare administron në Bankën Qendrore të Kosovës. Ndërsa, shuma prej EUR 11,946 e paraqitur në kolonën e parafundit është shuma totale e inkasuar në llogarinë e tarifës administrative e hapur për AKP-në që Thesari i Ministrisë së Financave e menaxhon dhe administron. [Për këtë llogari bankare, shih shënimin shpjegues nr. 1.4.](#)

Nga tërë procesi 2003 - 2017 për të gjitha shitjet dhe të hyrat e tjera (konfiskime të BID depozitave dhe tarifa për pjesëmarrje të tenderëve) gjithsej të hyrat e realizuara në llogarinë bankare që AKP-ja e administron janë **EUR 43,636,465**. Këto mjete janë inkasuar në llogarinë bankare të tarifës administrative të cilën AKP-ja e menaxhon dhe administron.

Ndërsa sa i përket transferimit të mjeteve në llogarinë e tarifës administrative të cilën Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave e administron të dhënat janë paraqitur si më poshtë.

11.1. Të hyrat e dedikuara për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative të AKP-së

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur shumat e transferuara për buxhetet e viteve 2011 – 2017 sipas vlerës së buxhetuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri më tani shumat e transferuar për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative për buxhetet e AKP-së janë EUR 38,248,000:

NR.	PËRSHKRIMI DHE DATA E TRASFERËVE	PËR BUXHETIN E VITIT	GJITHSEJ
1	Transfer gjatë vitit 2011	2011	1,800,000
2	Transfer me 28 Maj 2012	2012	8,200,000
3	Transfer me 28 Dhjetor 2012	2013	8,048,000
4	Transfer shtesë me 18 Nëntor 2012	2014	2,300,000
5	Transfer shtesë me 15 Janar 2015	2015	5,500,000
6	Transfer shtesë me 15 Janar 2016	2016	6,300,000
7	Transfer shtesë me 20 Janar 2017	2017	6,100,000
GJITHSEJ PAGESAT			38,248,000

Gjithashtu, para se të fillohet të operohet me llogarinë e tarifës administrative, gjatë vitit 2011 janë transferuar gjithsej EUR 1,800,000.

Mjetet e paraqitura që janë shpalosur më lartë, nga pika katër deri në shtatë, janë transferuar vetëm për ato shuma shtesë të nevojshme për të mbuluar buxhetin e periudhës fiskale, pasi që kemi pasur mjete të pa shpenzuar dhe këto mjete sipas Ligjit të Buxhetit dhe të AKP-së barten në vitin e ardhshme.

Mjetet e bartura prej EUR 872,086 nga tepricat e pa shpenzuara të vitit paraprak si dhe shuma prej EUR 6,100,000 kanë mbuluar buxhetin e vitit 2017 të AKP-së të aprovuar nga Kuvendi për shpenzimeve operative dhe administrative. *Për më tepër, shih shënimin shpjegues nr. 19*

AKP-ja nuk planifikon të hyra si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Thesari i Ministrisë së Financave është kërkuar që të paraqitet si e hyrë vetëm transferi bankar në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit. Shuma e buxhetuar prej EUR 6,920,884 nuk është planifikim i të hyrave por planifikim i shpenzimeve. Shumën e të hyrave totale që deri më tani AKP-ja ka akumuluar është prej EUR 43.6 milion, e cila është paraqitur më lartë.

Shënim:

Duke filluar nga viti 2019, sipas Ligjit aktual, përkatësisht nenit 21, AKP-ja nuk do të ketë mjete në dispozicion që të mbuloj aktivitetet e saj administrative dhe operative. Mungesa e mjeteve, nuk do të mundësoj përmbushjen e misionit dhe objektivave të përcaktuar sipas këtij Ligji, nëpërmjet të cilës është themeluar Agjencia Kosovare e Privatizimit, si përgjegjëse kryesore në zbatim të këtij po këtij Ligji.

Detajet e tjera të pagesave për fondet në mirëbesim, janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

SHËNIMI 12 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar Grante nga Donatorët.

SHËNIMI 13 HUAMARRJET

Agjencia nuk është e përfshirë në huazimin e fondeve.

SHËNIMI 14 TË ARKËTUESHMET

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2017	2016	2015
		€	€	€
61000	Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile	2,265	3,129	5,770
GJITHSEJ		2,265	3,129	5,770

Sipas politikës dhe procedurave të AKP-së për telefoninë fikse dhe mobile, AKP-ja për stafin dhe menaxhmentin mbulon një pjesë të shpenzimeve të krijuara. Shuma e tejkaluar mbi kufirin e caktuar kompensohet nga punëtorët dhe menaxhmenti.

Gjendja e faturave të papaguara gjatë vitit 2017, përfshinë periudhën e faturimit deri më 30 Tetor 2017.

PËRSHKRIMI	Vlera
Gjendja fillestare e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2016	3,129
Faturat e përcjella nga PTK për Nëntor 2016 – Tetor 2017	+ 9,537
Pagesat dhe ndalesat në pagë gjatë periudhës raportuese	- (10,207)
Kthimet e mjeteve të paguara më shumë pas kreditimit të faturave	- (194)
Bilanci i llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017	= 2,265

Duke filluar nga periudha nëntor 2017, menaxhmenti ka ndryshuar politikën për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë mobile duke e kaluar të gjithë stafin e AKP-së në “prepaid”. Kjo do të thotë se, tani më AKP-ja për rastet e telefonisë mobile nuk pranon mjete. Si rrjedhojë, nuk do të ketë llogari të arkëtueshme. Ndërsa nga shuma prej EUR 2,265, obligime të papaguara të zyrtarëve që kanë lëshuar punën nga stafi ndërkombëtar dhe vendor dhe i përkasin periudhës para vitit 2014.

Ndërsa për shpenzimet e telefonisë fikse, që janë përdorur për thirrje private, gjatë vitit 2018 do të përpilohet listë e hollësishme e këtyre shpenzimeve, në mënyrë që pastaj të bëhet ndalesë në pagë.

SHËNIMI 15 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	2017 €	2016 €	2015 €
11	Paga dhe rroga	-	-	-
13	Mallra dhe shërbime	55,742	14,167	2,868
14	Shpenzime komunale	6,748	1,511	580
20	Transfere dhe subvencione	-	-	-
30	Shpenzime kapitale	-	-	-
	Gjithsej	62,490	15,678	3,448

Në shumatat e obligimeve të papaguara janë të paraqitura sipas datës së pranimit të faturave, për të cilat është raportuar në Thesar të Ministrisë së Financave si dhe për shpenzimet e vitit 2017, fatura të cilat janë pranuar në vitin 2018 dhe rastet tjera të njohura për AKP-në (fatura që ende nuk janë pranuar). Të dhënat detaje janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 3

Pjesa më e madhe e faturave për këto obligime është pranuar në janar 2018 duke përfshirë edhe periudhën e pranimit të faturave që janë pranuar pas përfundimit të afatit për pagesë, afat i përcaktuar nga Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave. Gjithsej këto obligime janë EUR 51 mijë.

SHËNIMI 16 DETYRIMET KONTINGJENTE

Detyrimet kontingjente paraqiten në rastet kur malli dhe shërbimi i pranuar nuk është në përputhje me kushtet e kontraktuara.

Natyra e detyrimeve kontingjente	Arsyeja për detyrime	2017	2016	2015
		€	€	€
Pezullim nga puna për punëtorët të AKP-së	Llogaritja e 50% të pagës bruto në përputhje me ligjin shërbyesit civil (duke e përfshirë edhe 5% e punëdhënësit)	186,027	174,440	-
Shërbime për mirëmbajtje të fotokopjes	EUR 215.86 janë të papaguara, një pjesë të mjeteve nuk e mbulon kontrata dhe gabim teknik i shënuar në faturim F-15-2295	216	216	216
Shërbime për mirëmbajtje të fotokopjes	Fatura me nr. SH-1089/2016 lidhur me shërbimet e fotokopjimit është në vlerë prej € 1,232.09, janë paguar vetëm € 600. Pjesa prej € 632.09 nuk ka pasur mbulese në kontratë.	632	632	-
Shërbimet e përkthimit	Fatura me nr. IN2413 lidhur me shërbimet për përkthime është në vlerë prej € 654.79, janë paguar € 474.39. Për pjesën prej € 180.4 është tejkaluar vlera e kontratës.	180	180	-
Të ndryshme	Të bartura në llogaritë e pagueshme dhe paguara në vitin 2016	-	-	19,088
Gjithsej		187,055	175,469	19,304

Gjithashtu, AKP-ja kalkulon edhe shpenzimet të cilat mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat nuk janë shpenzime të paplanifikuara si rrjedhojë e faktorëve të jashtëm. Më poshtë janë të paraqitura ngjarjet:

PËRSHKRIMI	Vlera
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 Dhjetor 2016	175,469
Llogaritja e 50% e pagës deri në vendim të gjykatës për periudhën janar – dhjetor 2017 për zyrtarët që janë në procedurë gjyqësore	+ 67,238
Vendimet përfundimtare të gjykatës për zyrtar të cilët NUK do të kompensohen me pagë	- (55,652)
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 dhjetor 2017	= 187,055

SHËNIMI 17 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)

	2017	2016	2015
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Ndërtesat	123,686	127,571	131,457
Pajisjet	39,547	51,255	75,678
Automjetet	54,095	77,083	127,236
Kapital tjetër	12,231	19,966	27,702
Gjithsej	229,559	275,875	362,073

* janë paraqitur vlerat neto pas zhvlerësimit të realizuar deri më 31 dhjetor 2017

Nëse një pasuri është ende në përdorim, mbahet në Regjistrin e Pasurive të AKP-së edhe pse vlera e tyre për llogaritje është zero. Pasuritë të cilat nuk janë në përdorim (të dëmtuara) mbahen në regjister deri në momentin e asgjësimit të pasurisë bazuar në Udhëzimin Administrativ të MF-së.

Zhvlerësimi i pasurive:

AKP raporton koston historike, zhvlerësimin dhe vlerën neto të pasurive deri më 31 dhjetor 2017. Të dhënat janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 4

Vlera neto e pasurive kapitale deri më 31 dhjetor 2017 është EUR 229,559.

Meqenëse është një data-bazë “E-Pasuria”, nëpërmjet të cilës të gjitha institucionet do të regjistrojnë, monitorojnë dhe kontrollojnë asetet e tyre, gjithashtu Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka data-bazën e saj të veçantë për menaxhimin e asetëve të AKP-së. Kjo për shkak se data-baza “E-Pasuria” ndër-vite nuk ka qenë funksionale, për të cilën, tek personat përgjegjës kemi kërkuar që kjo data-bazë të funksionalizohet duke eliminuar mangësitë dhe pengesat në azhurnimin dhe menaxhimin e të dhënave.

Edhe këtë vit, ne kemi mbajtur takime dhe kemi përcjell shkresa zyrtare nëpërmjet të cilave kemi kërkuar që data-baza “E-Pasuria” të jetë funksionale edhe për AKP-në. Në fund të vitit, personat përgjegjës për administrimin e “E-Pasuria” kanë përcjell një listë të strukturuar nëpërmjet të cilës do të migrohen të gjitha shënimet, nga fillimi, dhe pastaj do të bëjmë harmonizimin e shënimeve tona me shënimet e “E-Pasuria”. Pastaj në një periudhë, AKP-ja do të mbaj paralelisht dy data-bazat dhe nëse në të ardhmen nuk do të paraqiten probleme dhe “E-Pasuria” është funksionale, AKP-ja do të fillojë që të azhurnoj dhe mirëmbajë shënimet vetëm në “E-Pasuria”.

SHËNIMI 18 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO)

AKP-ja bënë llogaritjen e zhvlerësimit sipas (udhëzimet UA 2009/21 dhe rregullorja 2/2013 e datës 18 Nëntor 2013 e MF-së për menaxhimin e pasurive) ato janë të paraqitura si më poshtë:

- Zhvlerësimi bëhet sipas metodës drejtvizore bazuar në jetë gjatësinë e përdorimit të pajisjes.
- Llogarita e zhvlerësimit nuk bëhen në muajin e parë të blerjes;

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Meqenëse nuk ka udhëzues nga Ministria e Financave se si të kalkulohen zhvlerësimet për inventar, ne kemi zhvlerësuar sipas metodës të sipërshtuar.

	2017	2016	2015
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Pajisjet dhe mobilet	56,978	90,121	73,533
Gjithsej	56,978	90,121	73,533

Të dhënat detaje janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 4

SHËNIMI 19 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA

Sa i përket të hyrave gjatë vitit 2017 prej EUR **6,111,946** ato janë si më poshtë:

- Transferimi i mjeteve prej EUR 6,100,000, *Shih shënimin shpjegues nr. 11;*
- Inkasimet e mjeteve të telefonisë mobile prej EUR 4,035;
- Kthimi i mjeteve nga kompania e sigurimit për dëmin kasko prej EUR 1,458; dhe
- Kthimi i mjeteve të ekzekutuar gabimisht nga përmbaruesi privat prej EUR 6,365. *Shih shënimin shpjegues nr. 3.3.1*

	2017	2016	2015
Përshkrimi	€	€	€
Të hyrat dedikuara të bartura nga viti i kaluar	872,086	863,529	1,315,428
Të hyrat e dedikuara të pranuar në këtë vit	6,111,946	6,311,932	5,507,796
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	6,984,032	7,175,461	6,823,224
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	(6,223,303)	(6,303,375)	(5,959,695)
Shuma e mbetur për bartje	760,729	872,086	863,529

SHËNIMI 20 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE

Agjencia Kosovare e Privatizimit, në tabelën e mësipërme ka paraqitur numrin e punëtorëve sipas programit buxhetor në Ministrinë e Financave. Për sqarim, ky numër i punëtorëve nuk është vetëm në këtë Departament, por në Departamentet, Njësitë dhe 5 Zyrat Rajonale të AKP-së.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2017		Nr aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2016		Nr aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2015	
	I aprovuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Administratës	258	238	-	249	-	250	-
Gjithsej	258	238	-	249	-	250	-

*Shpalosja në detaje janë bërë në shënimin shpjegues nr. 2 për paga dhe rroga.

SHËNIMI 21 RAPORT PËR NUMRIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2017		Nr aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2016		Nr aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2015	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Likuidimit	16	-	10	-	5	-
Njësia e Riorganizimit	14	-	6	-	-	-
Departamenti i Shitjes	-	-	4	-	-	-
Departamenti Ligjor	1	-	-	-	-	-
Gjithsej	31	-	20	-	5	-

AKP-ja ka angazhuar Ofruesit e Shërbimeve për çështjet që kanë të bëjnë si më poshtë:

1. **Departamenti i Likuidimit** –Këto shërbime kanë të bëjnë për NSh që janë në tranzicion: regjistrimin e kërkesave, ekzaminim fizik të pasurive dhe dokumentacionit, mbledhja e regjistrimeve të inventarit; listat e të punësuarve për shpërndarjen e 20%; emrat e kreditorëve dhe dokumentacionit dhe arkivimi i tyre për disa Ndërmarrje;
2. **Njësia e Riorganizimit dhe Administrimi Direkt i NSh-ve.** Nga AKP-ja për NSh-të të cilat i ka nën administrim direkt, ka angazhuar Ofrues të Shërbimeve për ruajtjen e aseteve;
3. **Departamenti Ligjor** – Shërbimet kanë të bëjnë me ofrimin e opinionëve Ligjore profesionale dhe këshilla juridike si dhe përgatitjen dhe rishikimin e akteve juridike që kanë të bëjnë me ndërmarrjet dhe etnitetet të cilat janë në administrimin e Agjencisë. Ky person ka përfunduar shërbimet në muajin nëntor 2017, ka qenë në kontratë në vepër për periudhë (6 muajore) për shërbime të veçantë.

AKP-ja ka të ndarë dhe aprovuar buxhetin nga Kuvendi i Kosovës për nënvijat buxhetore dhe programet buxhetore të shënuar më sipër. **Detajet e pagesave janë të paraqitura në shënimin shpjegues nr. 3 “Mallra dhe Shërbime”.**

SHËNIMI 22 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Më poshtë po paraqesim vetëm një raport të Adresimit përkatës të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) sipas vitit fiskal që është Audituar.

Viti	Tejkaluar	Zbatuar	Jo	Pjesërisht	Gjithsej	Tejkaluar	Zbatuar	Jo	Pjesërisht	Gjithsej
2013	3	19	1	2	25	12%	76%	4%	8%	100%
2014	5	16	1	3	25	20%	64%	4%	12%	100%
2015	2	14	0	6	22	9%	64%	0%	27%	100%
2016	2	7	0	10	19	11%	37%	0%	53%	100%
Gjithsej	12	56	2	21	91	13%	62%	2%	23%	100%

Në shtojcën e pasqyrave financiare është i bashkangjitur raporti i zbatimit të rekomandimeve nga ZKA.

- FUND -